



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme

URDHER

Nr. 103 Date 15.4.2004

PER

TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE "UJESJELLES KANALIZIME"
MALLAKASTER, NE SHOQERI ANONIME "UJESJELLES KANALIZIME" SH.A
MALLAKASTER,

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 8067, date 15.02.1992; nr. 8099, date 28.03.1996; nr. 8158, date 1.09.1997; nr. 8482, date 10.05.1999, dhe me Dekretet nr. 1195, date 14.08.1995 dhe nr. 1615, date 20.09.1996, bazuar ne percaktimin nga eksperti kontabel i autorizuar i kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes "Ujesjelles Kanalizime" Mallakaster, meqellim krijimin e akteve te themelimit te Shoqerise "Ujesjelles Kanalizime" Mallakaster, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

URDHEROJ :

1. Transformimin e Ndermarrjes "Ujesjelles Kanalizime" Mallakaster, ne Shoqeri te formes anonime "Ujesjelles Kanalizime" SH.A Mallakaster.
2. Anetare te keshillit te pare mbikqyres emerohen:
Z. Robert Shehaj
Z. Ermira Spahaj
Znj. Andi Sula
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

